

Termet e Referencës

Për kontraktimin e një konsulenti individual, ekspert në administrim biznesi, kontabilitet dhe tatime

Gratë përfitueseve të projektit IWKA do marrin një trajnim të nivelit fillestar mbi kërkesat administrative të drejtimit të biznesit dhe kontabilitetit bazë. Gratë gjithashtu do të identifikojnë nevojat e tyre shtesë për trajnim ku K-W4W dhe CARE do të synojnë të mbulojnë të gjitha nevojat si për bizneset fillestare ashtu edhe për ato ekzisutese.

Si aktivitet shoqëruës, ekspertet femra, mundësisht nga ndërmarrjet bujqësore ekzistuese do të ftohen në këto trajnime dhe do të ofrojnë mbështetje për regjistrimin e biznesit të ri bujqësor - dhe të japin këshilla për detyrimet ndaj shtetit në lidhje me taksat dhe tarifat e tjera.

Objektivi i thirrjes:

Gratë e përzgjedhura të cilat janë të prirura për të drejtuar nje biznes do të trajnohen nga eksperti, me theks të veçantë në menaxhimin e biznesit, mbajtjes së shënimeve në fermë, taksat dhe detyrimet tjera ligjore me qëllim që ato të jenë të afëta të formalizojnë bizneset dhe të menaxhojnë mikrobizneset e tyre. Kështu projekti IWKA kërkon të kontraktojë një ekspert, i cili ka eksperiencën dhe kapacitetet e nevojshme, për të trajnuar temat në fushat e përmendura më lartë me c' rast do të zhvillojë një kuptim të përgjithshëm dhe bazik të menaxhimit të biznesit dhe sistemit financiar.

Përgjegjësitë:

Në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me ekipin kyç të projektit, puna e ekspertit duhet të përfshijë, por pa u kufizuar në detyrat e mëposhtme:

- Të jetë përgjegjës për trajnime në administrim biznesi dhe shërbime tjera këshilluese dhe mbështetëse;
- Të ofrojë ekspertizë mbi çështjet ligjore dhe taksave që lidhen me regjistrimin e bizneseve të reja;
- Të këshilloj pjesëmarrëset rreth sistemit të taksimit sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës;

Project implemented by

- Të japë inpute teknike për përmirësimin e modelit të biznesit, produkteve/ shërbimeve;
- Këshillim rreth kërkesave të cilat nevojiten për mbarëvajtjen e një biznesi;
- Këshillim për rritjen e kapaciteteve drejtuese të bizneseve;
- Konsulencë Financiare.

Kualifikimet dhe eksperiencia:

Personat e interesuar duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Diplomë universitare në administrim biznesi, financa, apo shkenca të ngjashme ekonomike;
- Të paktën 3 vjet eksperiencë pune me startup-e ose fusha të ngjashme;
- Ekspertizë teorike dhe praktike në administrimin e biznesit;
- Ekspertizë teorike dhe praktike në çështje financiare të menaxhimit të një biznesi;
- Aftësi për të respektuar afatet, disponueshmëri dhe të demonstrojë korrektësi në kryerjen e shërbimit.
- Aftësi të mira ndërpersonale dhe ndër-kulturore;
- Aftësi organizuese dhe planifikuese;

Kandidatët që i plotësojnë kërkesat minimale duhet të përcjellin Ofertën financiare, CV-në, si dhe fushat në të cilat mund të mbajnë trajnimin, në email: human.resources@k-w4w.org jo më larg se **10 Mars 2023**.

Ju lutem vendoseni titullin e emailit: Aplikim për ekspert në administrim biznesi, kontabilitet dhe tatime.

Projekti "IWKA - Përfshirja e grave në agrobiznesin e Kosovës - Përmirësimi i statusit ekonomik dhe social të grave në Kosovë duke mbështetur agrobiznesin e udhëhequr nga gratë, financiar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) dhe zbatuar nga organizatat: Kosova-Women4Women, Care International dhe CRPK ka hapur thirrjen për grante në komunat: Prishtinë, Ferizaj, Graçanicë dhe Junik.